

LIBRI I PËRDORIMIT TË DRUVARIT

Njohuri bazë

SHPIEGIMI I THJESHTËZUAR



REGIONE
PIEMONTE

DIRETTORIA E EKONOMISË
MALORE DHE PYJORE



istituto per
le piante da legno
e l'ambiente ipla spa

Libri i Përdorimit të Druvarit është përpunuar mbrënda projektit formues "Teknikët e administrimit dhe organizimit në kantjeret pyjore": Masa C –Veprimi 2 "Formim në sektorin pyjor" që ka lidhje me Planin e Zhvillimit të Fshatrave 2000/2006 të Krahinës Piemonte (Krahina CE 1257/99). Realizuar me kontributin e bashkuar të Bashkimit Europian, Shtetit Italian dhe Krahinës Piemonte brenda planit të zhvillimit të fshatrave 2000/2006.

Falënderohen l'EFAS (Ekonomia pyjore e shoqatës Zvicerriane) dhe CFPF (Center de Formation Professionnelle des Forestiers-Bucheron) për autorizimin e teksteve dhe të figurave të pëmbledhura në librin e përdorimit.

Libri i Përdorimit të Druvarit është pasuri e Krahinës Piemonte, riprodhimi i pjesshem ose i plotë i teksteve dhe i figurave duhet të jetë i autorizuar.

Përkthimi, përshtatjet dhe faqosja janë hartuar nga I.P.L.A. S.p.A. (Istituti i Drurit dhe Ambientit www.ipla.org).

Revizionimi , thjeshtëzimi dhe koriggjimi i teksteve janë hartuar nga:

Pierpaolo Brenta, doktor pyjor, instruktor pyjor dhe kryetar i kursit (IPLA); Revizionimi, thjeshtëzimi dhe koriggjimi i teksteve janë hartuar nga:

Pierpaolo Brenta, doktor pyjor, instruktor pyjor dhe kryetar i kursit (IPLA);

Paolo Cielo, doktor pyjor, instruktor pyjor dhe kryetar i kursit;

Giorgio Dalmasso, doktor agronom, përgjegjës i sektorit të formimit IPLA;

me pjesëmarrjen e:

Valerio Motta Fre, doktor pyjor, Drejtorja e ekonomisë malore dhe pyjore, Krahina Piemonte;

Ruggero Marazzato, instruktor pyjor dhe kryetar i kursit;

Fausto Brunetto Prando, instruktor pyjor dhe kryetar i kursit.

Përkthimi është hartuar nga I.P.L.A (Istituti i drurit dhe ambientit).

Studimi grafik dhe faqosja e vëllimit janë hartuar nga:

Sektori hartografik dhe informatik–IPLA

Torino, Janar 2007



PARAQITJE	pag. 1
1. HYRJE	pag. 3
2. PARANDALIMI I AKSIDENTEVE DHE MBROJTJA E SHËNDETIT NË PUNËT NË PYELL	pag. 5
3. PRERJA	pag. 7
3.1 Rast normal	pag. 7
3.2 Hedhja përtokë e pemëve të ngatërruara	pag. 21
3.3 Teknikët e hedhjes përtokë të pemëve të përkulura në drejtimin e rënies	pag. 24
3.4 Teknikët e hedhjes përtokë të pemëve të përkulura në drejtim të kundërt të rënies: përdorimi i tirfor (çekrrik dysh) dhe i prerjes së gdhëndjes të gjërë	pag. 25
3.5 Teknikët e hedhjes përtokë për raste të veçanta	pag. 28
4. PËRGADITJA E DRURIT	pag. 31
4.1 Prerja e degëve	pag. 31
4.2 Rrotullimi i trungjeve	pag. 34
4.3 Prerja e trungut në shumë pjesë	pag. 35
5. MOTORRSTEGA (sharrë me motorr)	pag. 39
5.1 Blerja e një motorrstege	pag. 39
5.2 Pjesët përbërëse kryesore të motorrstegës	pag. 40
5.3 Përdorimi dhe mirëmbajtja e motorrstegës	pag. 48
5.4 Zinxhiri i motorrstegës; përbërja dhe përdorimi	pag. 52
5.5 Mirëmbajtje e zinxhirit	pag. 58
5.6 Blerja e një zinxhiri	pag. 60
6. NJOHJE DHE MIRËMBAJTJE E VEGLAVE	pag. 61
6.1 Rripi i punës	pag. 61
6.2 Kosa	pag. 62
6.3 Sakica	pag. 64
6.4 Kunjë alumini	pag. 69



Me këtë botim, permbledhje e më të plotës "*Libri i Perdorimit të Druvarit*", Krahina Piemonte i jep punëtorëve të pyjeve një instrument të vlefshëm, që nuk don të jet vetëm një mjet kompetenze dhe aftësie, por edhe mjet integrimi për punëtorët që nuk janë të gjuhës amtare italiane.

Në fakt, shpjegimi i thjeshtëzuar i "*Libri i Perdorimit të Druvarit*" është i rredaktuar në kater gjuhë: italisht, arabisht, shqip, rumanisht dhe paraqitet si një instrument kuptimit i vlefshëm për ato që zgjedhin me zhvillu profesionin e tyre në fushën e pyjeve dhe i përkasin shteteve që aktualisht janë në sektor.

Bëhet fjal për punë gjithmon e më të çmueshme, edhe sepse marrin pjesë të bëjnë të ngrihet një seksion në të cilin administracioni krahinor Piemontez mbështetet shumë: ekonomia pyjore, në fakt, jonetem mbulon përsëri një rëndësi kulturele të konsiderueshme dhe mbrojtje të ambientit, por jep mundësi zhvillimit terrioreve të varfër në fushën ekonomike dhe sociale.

Me një politikë edukimit dhe formimit të përshtatshme, dhe një vëmendje të veçantë të problemeve që kanë të bëjnë me sigurinë në punë, dhe mund të zhvillohen kultura profesionale të domosdoshme për një cilësi të lartë të prodhimit, duke dhënë të drejta rreala dhe duke marrur pjesë në rrealizimin e plotë në punë, duke kapërcyer prishjet e ekuilibrit të zonës dhe të shoqërisë.

Shpjegimi i thjeshtëzuar i "*Libri i Perdorimit të Druvarit*" komuikohet gjithë kjo: vëmendje profesionit dhe sigurisë në punë, integritetit social dhe zhvillimit me një pamje të orjentuar në të ardhmen.

Kshilltari krahinor
i zhvillimiti malor dhe pyjor
Mbrojtjes së tokëve dhe e ndërtimeve sociale

Bruna Sibille



HYRJE

Hedhja përtokë e pemëve, heqja e degëve, prerja, transportimi i pemëve në vendet e mbledhjes dhe përpunimi i drurit quhen "përdorime pyjore". Të tilla veprime mund të kryhen si në fushën e punëve për përmirsimin e terreneve pyjor, gjithashtu edhe me qëllimin e mbledhjes së drurit për punë dhe drurit të zjarrit, kur pyelli të ketë arritur pjekurinë.

Përdorimet pyjore bashkë me kaparimet, rindërtimet dhe realizimin e infrastrukturave, të cilët shtegu, pista, rrugë dhe vende përpunimi, përfaqësojnë të gjitha gjërat e bëra nga njeriu në terrenet e pyllëzuara me qëllim që të garantohet ruajtja dhe një prodhim kostant (mbrojtje hidrogeologjike, ruajtje e ambienteve natyrore dhe vendeve të gjelbërta për mirëqënien e njeriut).

Përsa i përket organizimit të pylltarisë moderne dhe racionale, punët pyjore, përveç rrespektimit të rregullave normative, duhet të zhvillohen në mënyrë që të garantojnë rigjenerimin e pyellit pas prerjes, të garantojnë siguri dhe mbrojtje shëndeti të punëtorëve dhe ti japin atyre fitime ekonomike të mjaftueshme.

Megjithë një mekanizim të cikleve të prodhimit, faktori kryesor për t'ia dalë mbanë kësaj pune është akoma faktor njerëzor. Për çdo tonelatë material janë të nevojshme 1,2 deri në 6 orë punë sipas dimensioneve të drurit, tipit të prerjes, sistemit të transportimit të drurit nga pyelli dhe të distancave relative.

Është shumë e rëndësishme të mund të mbështetemi në një forcë pune të kualifikuar dhe të motivuar për detyrat që i përkasin secilit. Për të arritur këtë rezultat duhet një formim i mirë profesional, një kompensim i mirë i punës që shpesh është e rëndë dhe kërkon transferim larg nga vendi i banimit dhe një organizim i punës që lejon të vlerësojmë kontributin e secilit puntor në procesin e prodhimit.

Përsa i përket sektorit publik rrolli më i rëndësishëm i përket punëtorëve të krahinës përkatëse për zhvillimin malor dhe pyjor, mbrojtjen e tokëve dhe të godinave, që i dedikohen mirëmbajtjes së pasurive pyjore të rajonit ose të pasurive të tjera publike dhe të fidanishtave pyjore të krahinës.

Në pronat bashkiake si në ato private punët e prerjes i besohen ndërmarrjeve të specializuara që blejnë drurin, bëjnë hedhjen përtokë dhe parashikojnë tregëtinë e pjesëve të përfituara (industrive ose direkt privatit). Të tilla ndërmarrje janë me dimensione të vogla (2-3 përfaqësues për unitet produktiv) dhe rezultojnë të rregjistruara në dhomën e tregtisë në seksionin artizan ose komercial (tregtar). Ka edhe shumë ndërmarrje që i dedikohen bujqësisë dhe prodhimit të drurit për tu djegur në stinën e dimrit.

Duke përjashtuar sa persona i dedikohen prerjes për konsum individual, që janë të shumtë, në përgjithësi punojnë në sektorin privat rreth 3.000 të ngarkuar në nivel krahinor, të cilëve u shtohen 700 punëtor të enteve publike.

Regione Piemonte ka gjetur në formimin profesional një nga faktorët strategjik për zhvillimin në këtë sektor, me qëllim që të arrisin objektivet e mëposhtme:

- të rrisim dhe të bëjmë të njëtrajtshëm bagazhin teknik e praktik në nivele të ndryshme kualifikimi;
- të rrisim ndjeshmërinë individuale në ballafaqim me temat e sigurisë;
- të rrisim produktivitetin e punës individuale dhe në grup;
- të rrisim vetëdijen tek punëtorët e sektorit, të rëndësisë të rolit social me qëllim zhvillimi ekonomik të hapësirave fshatarake dhe për mbrojtjen e pasurive pyjore dhe të etjes hidrogeologjike.

Ky libër përdorimi, që rrezulton një përmbledhje e disa mjeteve mësimor të tjera nga shumë kohë të përdorura në nivel rajonal, është i destinuar për të gjithë ato që ofrohen për qëllime profesionale. Ai përmban nocione bazë për një përdorim të sigurtë dhe produktiv të motorrstegës dhe të veglave të tjera prerëse dhe duhet të vlerësohet si një mjet mësimor që duhet të konsultohet sa herë që të kemi një dyshim ose një problem në punë, gjë e cila nuk mund të zëvendësojë mësimin nga instruktorët e kualifikuar as asistencën në kantier nga personat ekspert.



PARANDALIMI I AKSIDENTETEVE DHE MBROJTJA E SHËNDETIT NË PUNËT NË PYELL

Puna e punëtorit të pyjeve është e njohur si një ndër më të rrezikshmet, sepse është vazhdimisht e ekspozuar në rreziqe të ndryshme dhe si konsekuencë ka një mundësi të madhe aksidentesh në punë. Pikërisht për këtë arsye, siguria në pyell duhet të jetë e organizuar dhe e drejtuar në nivele të ndryshme: nga identifikimi dhe vlersimi i rrisqeve, te planifikimi dhe organizimi i aktivitetit, te adoptimi i teknikëve të punës të përshtatshme dhe të sigurisë domosdoshme. Të gjithë përsoneat janë të nderlikuar: porositësi i punës, punëdhënësi, kryetari i grupit ose i posaçmi i veprimit (punëtori i vetëm), sipas përgjegjësiive sigurisht të specifikuara nga ligji.

Duke ju referuar statistikave të sektorit mund të përcaktohet tabela që ndjek: rreth 40% të aksidenteve në punë ka si shkak veprues dëmtimin e trungut, trungjeve dhe degëve, 30% është konsequent nga prerjet e praktikuara me motorrstegë (sharra për prerjen e drurit) ose vegla të tjera, il 20% nga rrëzimi, pjesa që mbetet 10% ka të bëjnë me përdorimin e traktoreve dhe makinave të tjera. Motorrstega paraqet veglën më të rrezikshme me të cilën punëtorët e pyjeve duhet të punojnë dhe pakujdesi është shkaku kryesor i aksidenteve.

Hedhja përtok është faza më e rrezikshme, si për rëndësinë dhe shpeshtësinë relative, por pjesa më e madhe e aksidenteve në punë verifikohet gjatë përgaditjes së drurit, që angazhon punëtorin në kohë të gjatë dhe kërkon një qëndrin në të cilin shuli i motorrstegës është afër këmbëve. Në heqjen e drurit nga pyelli numërohet një numër më i vogël aksidentesh, por me rëndësi shpesh më të larta.

Ndër aksidentet më me pak rëndësi por që verifikohen me frekuencë më të madhe dhe mund të përcaktojnë një paaftësi të përkohshme për disa ditë (perveç që është shkak i aksidenteve më të rënda) janë traumat në mes të kurrizit, hyrja e ashklave në durë dhe fëtyrë dhe pickimi i insekteve dhe në përgjithësi rreziqet e prejardhura nga ekspozicioni i vepruesve biologjik.

Edhe kur të përdoren të gjitha masat paraprake mund të mbesin rreziqe në të cilët efektet mund të jenë të parandaluara ose të fashituara me përdorimin korrekt të sistemeve të mbrojtjes të individit (DPI). Përdorimi i DPI është berë i detyrueshëm nga D. lgs. 626/94, mospërdorimi i këtyre sistemeve sjell sanksione ekzekutive dhe penale. Të gjithë DPI duhet të kenë vulosjen CE në garantimin e rrespektit të normave të rreferimit.

Paisja complete e DH për punëtorin e pyjeve është e paraqitur në figurat e mëposhtme:



Është e nevojshme të formohet një "mentalitet sigurie" në vendin e punës duke hequr gjykimin sipas të cilit i DPI sjellim një humbje të prodhimit (n.q.s. janë të parehatshme, të rënda dhe kabahe) dhe të lekëve (për blerjen e tyre). Mjafton me fol me pylltar ekspert për të dëgjuar që tregojnë për shumë aksidente në të cilët kasketa ose pantallonat kanë shpëtuar jetën e ndonjërit, ndërsa mungesa e tyre ka sjell konsekuenca të plagosurit.

Megjithatë duhet të nënvizojmë që vetëm përdorimi i DPI nuk mjafton të vënë në mbrojtje punëtorin nga aksidentet që mund të ndodhin. Punëtorët duhet të jenë të formuar në punën konkrete dhe të jenë të informuar korrektësisht për përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të mbrojtjes dhe për vantazhet që këto sjellin në punë.

DPI shërbejnë edhe për të zvogëluar efektet negative në trupin e njeriut nga zhurma, dridhjet, pluhurat dhe gazet në të cilët druvari është i ekspozuar sidomos kur përdor sharrën për prerjen e drurit. Duhet të kujtojmë që përdorimi për kohë të gjatë i motorrstegës pa mbrojtjen e veshëve sjell me siguri shurdhim të pjesshëm, ndërsa përdorimi i dorezave zvoglon dridhjet që të kalon kjo vegël segmentin dorë-krah dhe parandalon shfaqjen e sëmundje neuroshqisor dhe të nyjeve.



PRERJA

Konsiston në prerjen në këmben e pemëve dhe në hedhjen përtokë të tyre. Ky operacion bëhet zakonisht me përdorimin e sharrës për prerjen e drurit dhe veglave të dobishme për përcaktimin e drejtimit të rënies së pemëve, të cilat janë prizmi trekëndësh(kunjet), dhe leva e hedhjes përtokë, tirfor, etj. Është një veprim i rrezikshëm, në cilin rregjistrohet numri më i madh i aksidenteve vdekjeprurës. Në vijim paraqiten disa teknika të hedhjes përtokë të dobishme për mbledhjen e drurit në të gjitha kushtet operuese. Teknika të veçanta për raste të veçanta, të rrezervuara për punëtorë ekspert vinë të thëna dhe për trajtimin e tyre i referohemi mbështetje të tjera didaktike të thëna në bibliografi.

3.1 RAST NORMAL

Sekuenza e operacioneve që duhen bërë për prerjen e pemëve me dimensione të mesme ose të mëdha, me trung të drejtë dhe degëzim të përhapur njëtrajtësisht.

1. vëndosni drejtimin e heqjes së drurit nga pylli dhe atë të rënies;
2. vëndosni korrektësisht veglat;
3. vëndosni saktësisht drejtimin e rënies, vëreni zonat e rrezikut dhe rënies;
4. ekzaminoni pemën dhe zonat rrethuese;
5. lironi bazën e pemës dhe përcaktoni një rrugë ikjeje (largimi);
6. preni mbrojtjen radicale (të mundëshme);
7. vëndosni përmasat e drejtimit të prerjes;
8. kontroll i drejtimit të prerjes;
9. vëndosim gjërësinë e menteshës;
10. thirrja e lajmërimit "kujdes";
11. fillojmë prerjen;
12. kontrollojmë drejtimin e rënies, bëjmë korrigjime të mundëshme;
13. presim pemën;
14. menjëherë pas rënies, vërejmë gjithë zonën e rënies për të verifikuar ndonjë rrezik të mundshëm; eliminojmë rrezikun;
15. vërejtje e cung, eliminojmë krëhërin, mbrojtjen, bëjme prerjen e trungut.

3.1.1. Vëndosim drejtimin e transportimit të pemëve dhe pastaj atë të rënies

Mbi bazën e organizimit të kantierit është e muajtur të vëndosim drejtimin e transportit të pemëve dhe pastaj drejtimin e rënies së tyre. Veglat duhen të vëndosen në drejtimin e kundërt të rënies së pemës.

3.1.2. Vëndosja korrekte e veglave



Veglat duhen të vëndosen në krah të kundërt të rënies, të rreshtuara njëra pas tjetrës, në mënyrë që të mos përbëjnë rrezik në fazat që vijnë. Gjatë punës të merren dhe të vëndosen rregullisht veglat, kjo do t'ju evitojë humbje kohe për gjetjen e tyre në rast humbje.

3.1.3. Vëndosja ekuake e drejtimit të rënies

Bëhet fjalë të gjindet një korridor rënie në të cilin pema mund të rrëzohet pa u penguar në pemë të tjera dhe pa bërë dëme. Gjatë këtij vlerësimi druvari duhet të mendojë për kushtet e zonës rrethuese dhe të vëndos për operacionet që vijnë. Nga hedhja përtokë duhen të merren asortimente të cilësisë më të mira duke evituar dëmtime të pjesëve që mbeten në pyell gjatë transportimit të drurit.

Mbi bazën e organizimit të kantierit, të një ekzaminimi të përgjithshëm të pemës, të pjesëve që duhen prodhuar dhe të rregullave elementare të sigurisë, duhet të vëndoset ekuaktësisht drejtimi i rënies, sipas kësaj procedure:

- verifikoni korridore, hapësira për rënie;
- zgjidhni hapësirën e rënies më funksionale ndërmjet vlerësimit të rregullave të mëposhtme.

Drejtimi i përqëndrimit dhe i transportimit të drurit në qëndrat e mbledhjes

Vëreni zonën duke eliminuar hapësirat e rënies që nuk lejojnë kryerjen e transportimit në kushte të mira.

Dëmtime në pyllin rrethues


Nëpërmjet korridoreve të mbetura eliminoni ato ku nuk ka pemë për tu prerë.

Dëmtime të pemës që do të hedhim përtokë

Në lidhje me vlerën e pemës që do të hedhim përtokë nuk marrim parasysh korridore ku ka pengesa natyrale (cungai, gurë të mëdhenj) që mund të prishin pjesët në fazën e rënies ose të transportit në vendin e mbledhjes së drurit.

Kushte pune më të favorshme

Pasi kemi vëzhguar pikat e mësipërme, zgjidhni ato korridore që ofrojnë kushte më të mira pune dhe që lejojnë të kryhen veprime të nryeshme në siguri.



3.1.4. Ekzaminim i pemëve dhe i zonës rrethuese

Pasi keni zgjedhur drejtimin e saktë të rënies, duhet të ekzaminoni pemën që do të hedhni përtokë dhe zonën rrethuese, me qëllim që ti garantojmë punëtorit siguri gjatë fazave të nryeshme të hedhjes përtokë të pemës, të evitojmë aksidentet, reduktim i kohës së punës dhe i transportimit të trungjeve, duke razionalizuar sa më mirë veprimet e nryshme. Ja disa shembuj për verifikimin dhe vlerësimin e pemës.

Ku të ekzaminojmë?

Çfarë verifikojmë?

Çfarë vlerësojmë?

a. Pema

Çfarë lloji?

Marrim parasysh karakteristikat dhe llojin (gjatësinë e fijeve) për të përcaktuar menteshën dhe rreziqet e thyerjes.

b. Këmba



Diametri

Zgjidhni teknikën e duhura dhe veglat për prerjen.

Zmadhimi i rrënjës

Vendosini se, dhe kur ti eliminoni.

Forma dhe dëmtime

Nëse ka, vëndosni dhe marrni parasysh llojin e prerjes.

c. Trungu



Prezencë e një kanceri peme, vrima rrahjeje, plagë, kalbësira, etj.

Të bëhet kujdes ndaj reaksioneve gjatë rënies së pemës:

- rrezik thyerje gjatë rënies;
- zgjedhje korrekte e rrugës së ikjes.



Prezencë e ndarjes së trungut, kthesa

Parashikoni rreaksionet në momentin kur do prekin tokën:

- rrezik ngritjeje në krah ose mbrapa;
- zgjidhje e mirë e rrugës së ikjes.

Përkulje

Të vlerësoni sbilancimin e pemës (pika vijuese).

d. Kurora



Ndarja e peshës së kurorës mbi trung, p.sh. përkulur majtas.

Lëni një menteshë më të gjërë djathtas.

Modifikoni prerjen (e përqëndruar djathtas në funksion të përkuljes së pemës).

Parashikoni montimin e tirfor (çekrrik dysh).

Preni së pari pjesën që është nën presion.

Degëzime primare

Vëreni degëzimet gjatë rënies së pemës dhe zgjedhni një vend të sigurtë, duke vlerësuar:

- rrezik thyerje;
- rrezik që të ngatërrohet;
- rrezik spostimi anash ose mbrapa pemës në fazë rënie.

Degëzime sekondare

Parashikoni dëmet e veçanta:

- rënie e parakohëshme dhe e shpejtë;
- rrezik kërcimi dhe spostimi i këmbës në fazën e rënies në kontakt me tokën;
- zgjedhje e saktë e rrugës së ikjes.

e. Gjatësia



Vlerësimi i gjatësisë

Përcaktoni vëndin që zë përtokë (dyfishi i gjatësisë).

Llogaritni zonën e rënies dhe të rrezikut.

Përcaktoni rreziqet për kolegët, prani rrugësh, shtegjesh, shtëpie, linja elektrike etj.

f. Koridore rënie



Kalimi i kurorës

Vlerësoni mundësinë e kalimit në korridor pa mbetur e ngatërruar, parashikoni veglat e nevojshme, lajmëroni rojet në qoftë se pema rrezikon të mbetet e ngatërruar.

Pemët afër njëra tjetrës që preken në fazë rënie mund të lëkunden

Të keni vëmendjen në hapësirat e prekjes së këtyre pemëve, vëzhgojini me vëmendje gjatë rënies dhe menjëherë pas saj.

Drejtimi i rënies

Të keni gjithmonë parasysh që pema mund të bie në një drejtim tjetër dhe të siguroheni që kjo mos të provokojë aksidente dhe dëme.

g. Rreziqe të nryshme dhe faktor të jashtëm



Degëzime të thata ose të thyera

Parashikoni një thyerje, të jeni të vëmendshëm dhe mos rrihi nën degëzime.

Forca dhe drejtimi i erës

Parashikoni modifikimet për të berë për të evituar që pema të mos ndërroj drejtim nga era.

Pemë e ngrirë

Parashikoni më përpara vështirësitë e rënies dhe rrezikun e thyerjes.

h. Hapësira rrethuese



Kolegu i punës në zonën e rrezikut

Njoftojeni në kohë dhe kontrolloni që të mos jetë në rrezik gjatë fazave të nryshme të hedhjes përtokë të pemës.

Rruga në zonën e rënies

Bllokoni rojet gjatë fazave të rrezikshme të punës.



Linja elektrike, rrugë, matriale etj.

Merrni masat e nevojshme për çdo situatë (psh. Lajmëroni shoqërinë e elektricitetit).

Pengesa në tokë, cung, trungje etj.

Të keni vëmendjen në reaksionet e mundëshme të këmbës së pemës në momentin e impaktit me tokën.



Degët dhe pengesa rreth këmbës

Lironi këmbën në mënyrë që të punoni në kushte të mira.

Rrugë ikje

Përcaktoni vendin e përshtatshëm për të qënë të sigurtë në funksionimin e të gjithë këtyre vrojtimeve.

Vërejtja e pemës dhe e zonës rrethuese ndërmjet një kontrolli dhe vlerësimi korrekt është një veprim i rëndësishëm për të siguruar një punë produktive, me cilësi, të sigurtë dhe pa aksidente.

3.1.5. Lirojmë bazën e pemës dhe vëndosim rrugën e ikjes

Zona rreth bazës të pemës duhet të jetë e lirë nga çdo gjë që mund të pengojë veprimet e hedhjes përtokë dhe përgaditjes.



Pemët e reja të së ardhmes mbikëqyren nëse përkulen me veglat e nevojshme ose me degë të ndara.

Përveç rasteve të veçanta, pema duhet të prihet sa më afër tokës, për të thjeshtëzuar punën që vijon dhe për të përdorur sa më mirë drurin.

Që mprehja e zinxhirit të motorrstegës të zgjasë më shumë, trungu duhet të jetë i pastruar mirë nga myku, rëra, dheja, gurët etj.



Është e rëndësishme të përcaktoni një rrugë ikje.

Bëhet fjalë me virifiku dhe me zgjedh zonën më të përshtatshme për të qënë të sigurtë gjatë rënies së pemës dhe të siguroheni që asnjë pengesë të mos ndalojë largimin tonë nga baza e trungut për në zonën e sigurtë.


3.1.6. Preja e zmadhimeve të rrënjës rreth pemës

Prania e zmadhimeve të rrënjës rreth pemës vështirëson prerjen dhe mbi të gjitha mund të influencojnë mbajtjen e zinxhirit. Në disa raste është e nevojshme të presim mbrojtjen rreth këmbës së pemës kur pema qëndron akoma në këmbë.

Çarja e parë horizontale që jep pikën e referimit (1 në figurë)

Duke u nisur nga pika më e lartë nga toka, prerja bëhet me zinxhirin e motorrsteqës në "tërheqje", duke u sjellur në sens orar rreth pemës, pa hyrë shumë në thellësi.

Kshillë: vëreni shulin për të bërë një prerje horizontale.




Prerja e zmadhimeve të rrëjës së pemës (2 në figurë)

Prerja e parë bëhet gjithmonë paralele me aksin e pemës, e dyta bëhet horizontalisht duke bërë kujdes që të koincidojnë dy prerjet (horizontale dhe vertikale). Nga dy prerje arrihet një anie. Puna vazhdon në drejtim të kundërt të akrepave të orës në mënyrë që të kemi pjesën e sheshtë të sharrës kundër trungut.

3.1.7. Vëndosja e përmasave të gdhëndjes së drejtimit

Gdhëndja ka si qëllim ti japë pemës drejtimin e rënies. Për të vazhduar hedhjen përtokë në një rast normal, duhen të aplikohen këto madhësi:

- thellësi prerje: $\frac{1}{5}$ e diametrit në bazë pa numëruar zmadhimet e rrënjës;
- hapje e prerjes: 45° (45 gradë).



3.1.8. Kontroll i gdhëndjes së drejtimit



Vëndosja korrekte e gdhëndjes (përmasa dhe drejtim) është e rëndësishme për të vëndosur drejtimin e saktë të rënies së pemës.

Një prerje e gabuar mund të provokojë punë të më tepërta , sforcime fizike të rënda dhe rrezik aksidentesh.

3.1.9. Vëndosja e gjërësisë së menteshës

Mentesha ka funksionin e drejtimit të pemës në fazën e rënies.

Mentesha është e vetmja mbështetje e pemës në fazën e rënies, pra roli i saj është shumë i rëndësishëm.

Në rastin e një peme normale, gjërësia e menteshës duhet të jetë 1/10 e diametrit të pemës pa marrë parasysh zmadhimet e rrënjës.

Në raste të tjera për të vëndosur dimensionet e menteshës duhet të kemi parasysh:

- **Iloj druri** (gjatësia dhe fortësia e fijeve influencojnë rënien në drejtimin e dëshiruar);

kanë fije të gjata:


- bredh i kuq
- bredh (i ri)
- larsh
- pishë
- frashër
- plep

kanë fije të shkurta:

- ah
- bredh (i vjetër)
- lis
- panjë
- vidh

Në fushën e llojeve të njëjta të drurit mund të variojnë sipas vëndit ku është rritur druri: për shëmbull një bredh i rritur në fushë ka dru me karakteristika mekanike më të vogla se një i rritur në lartësi (mentesha duhet të jetë më e gjërë).

- **Drejtimi i fijeve** në zonën e menteshës;




- **kushtet shëndetësore të drurit:** shtoni menteshën në qoftë se ka kalbësira;
- **ndarja e peshës:** shtoni menteshën nga krahi i kundërt i përkuljes së pemës;
- **teknika e punës:** përshtatje e menteshës me teknikën e përdorur.



Shënim

Për të shtuar eksperiencën tuaj, shënoni gjithmonë tek baza e pemës menteshën para se të bëni prerjen, kështu do të mësoni më shpejt të matni përmbasat e saj.


3.1.10. Përcaktoni zonën e rënies dhe të rrezikut



Rregullat e siguresës duhen të vihen gjithmonë përpara se të filloni prerjen dhe hedhjen përtokë.

1. Vëndosni rrugën e ikjes;
2. largoni përtej zonës së rënies të gjithë njerëzit;
3. vëreni zonat e rrezikshme, njoftoni kolegët, që duhet të ndalojnë punën dhe vëreni pemën që bie deri në fund të rënies;
4. bërtitni "kujdes" dhe vëreni me vëmendje sipërfaqen përpara se të vëni në punë motorrsteqën;
5. gjatë gjithë fazës ai që pren pemën është përgjegjës i sigorisë.

3.1.11. Fillojini prerjen e hedhjes përtokë



Përpara se të filloni prerjen e fundit është e detyrueshme të kontrolloni zonën e rrezikut, pastaj bërtitni "kujdes".

Derisa mentesha zhvillon funksionin e saj, prerja e hedhjes përtokë duhet të bëhet pak më lart se baza e gdhëndjes drejtuese. Në mënyrë të tillë fijet e menteshës mund të shoqërojnë rënien e pemës në fazat fillestare përpara se të thehet. Në momentin e thyerjes së menteshës fijet e krëhërit do të shkëputen nga këmba e pemës dhe jo nga trugu, duke marrur kështu një pjesë asortimentesh komerciale. Prerja e hedhjes përtokë duhet të bëhet në gjysmën e lartësisë të gdhëndjes së drejtimit (1/10 të diametrit). Prerja e hedhjes përtokë duhet të bëhet me një prerje horizontale.


Regulla bazë: në të gjithë rastet është e nevojshme të fillojmë prerjen nga zona nën presion.

Llojet e prerjes së hedhjes përtokë



Prerja në trajtë freskore e thjeshtë

Kjo prerje përdoret për pemët me diametër të vogël dhe kur lama është mjaftësisht e gjatë. Trupi i motorstegës rrin i ndalur, mbaja e lamës rrotullohet.




Prerja në trajtë freskorje e tëndosur

Kjo prerje përdoret për pemët me diametër më të madh se gjatësia e lamës. Një teknikë e tillë jep mundësi të preni në tëndosje dhe siguron një prerje horizontale.

1. Preni 2/3 duke përpendikuar nga mentesha;
2. kontrolloni dhe drejtoni prerjen me dorezën e lamës;
3. vëndosni kunjët dhe kompletoni prerjen e hedhjes përtokë.

3.1.12. Gjatë prerjes së hedhjes përtokë



Mos harroni kurrë të vërojtini zonat rrethuese dhe garantoni siguri.

Prerja e hedhjes përtokë bëhet deri te ndonjë centimetër nga mentesha e paracaktuar, për të muajtur të bëni korrigjime.

Kontrolloni drejtimin e hedhjes përtokë duke rrahur mbi kunjë, i cili do të jetë i pozicionuar saktësisht në vijë me drejtimin e rënies, dhe duke shikuar lëvizjen e kurorës së pemës.


Për shëmbull, në qoftë se pema ka prirje për të shkuar drejt së djathtës, duhet të lihet një menteshë më e gjërë nga e majta.

Puna me kunjë

Në qoftë se është e nevojshme kunjët do të jenë të vëndosur në zonën e ngjeshme, të rreshtuar mënyrë që të rrahin me lehtësi mbi të gjithë, nga i njejti vend. Jepni një goditje për çdo kunj, gjithmonë në të njëjtin rënd dhe me një rritëm të qëndrueshëm, që shton efektin dhe zvogëlon sforzimin.

Funksionimi i kunjeve:

- të ngadalësoni ngjeshjen e tehit;
- të kontrolloni drejtimin e rënies;
- provokoni rënien.



Pemë krejtësisht e drejtë

Pemë e pjerrtëzuar nga e majta

3.1.13. Pema bjen



Kur pema fillon të luajnë, të gjithë punët duhen të ndërprehen.

Të tërhiqeni nga zona e rënies pa humbur shikimin e elementeve në lëvizje.



Të vëreni zonën e rënies dhe pemën që bie.

3.1.14. Menjëherë pas rënies



Të ngritni kokën dhe të vëreni rreziqet që mund të ndodhin.

Të analizoni situatën e re.

Të hiqni ose të përkufizoni rreziqet.

3.1.15. Vrojtimi i cungut është një veprim për tu bërë mbas rënies së pemës



Vrojtimi i cungut jep të dhëna të rëndësishme.

Bëni vrojtimin e mëposhtëm:

- lëvizja e fijeve në menteshë;
- rrezistenca e drurit sipas llojit dhe moshës së pemës;
- gabimet e hedhjes përtokë, gdhëndja e drejtimit e pasaktë, prerja horizontale shumë e thellë, prerja e hedhjes përtokë shumë e shkurtër ose shumë e lartë, e pjerrët, vlerësimi i gabuar i drurit që mbetet, mungesa e vrojtimeve të difekteve, etj.

Pas punëve:

- pastroni cungun (preni ashklat për me ju shmang rreziqeve);
- preni krëhërin ose sharroni përsëri trungun, preni zmadhimet e rrënjës.

3.2


HEDHJA PËRTOKË E PEMËVE TË NGATËRRUARA

Në qoftëse një pemë ka mbetur e ngatërruar, është e detyrueshme ta bini përtokë sa më shpejt.


Përpara çdo gjëje duhet të kontrolloni situatën e re:

- siguria a është e garantuar?;
- cilat janë mjetet në dispozicion?;
- nga cila anë të sillni pemën?;
- ku është ngjeshja? – a është e nevojshme të lini një bashkues?;
- si të parandaloni bllokimin e lamës?;
- çfarë teknikësh të përdorni?;
- për çfarë materialit keni nevojë?.

1° rast: hedhje përtokë përmes një rrotullimi rreth një bashkuesi anësor




Preni zonën qendrore të menteshës deri afër bordit.



Preni bashkuesin anësorë në zonën e shënimit me sakicë (shigjeta horizontale).

Rrotulloni pemën me rrotulluesit e pemëve.



Si alternativë montoni tirfor (çekrrik dysh) për të rrotulluar pemën për ta zbllokuar.

2° rast: hedhja përtokë duke e prerë në këmbë



Në prerjet e drurit me diametër të vogël, që prodhojnë asortimente për industrinë ose për djegie, është e muajtur me hedh përtokë pemët e ngatërruara duke i ndarë në pjesë me 1 m gjatësi, duke vlerësuar herë pas here zonën e rënies dhe të rrezikut. Përsa i përket aksidenteve kjo metodë kërkon kujdes të madh.

Shëmbull:

1. vëreni dhe ekzaminoni situatën (zonën e tërheqjes dhe të shtypjes);
2. shkëputni trungun nga këmba e pemës duke prerë krejtësisht menteshën;
3. hiqni degët deri në lartësi të shpatullave;
4. matni dy pjesë trungu nga 1 metër secili;
5. preni në zonën e shtypjes një prerje të thellë të paktën sa gjysma e diametrit;
6. preni në zonën e tërheqjes duke lënë një menteshë të hollë;
7. shtyni pemën në zonën e prerë me ndihmën e një vegle që quhet (zappino);
8. vazhdoni dhe preni në shumë pjesë trungun derisa pema të bie përtokë;
9. kujdes rënien mbrapa pemës.

Shënim


Kjo teknikë është konsideruar e sigurtë për pemët me diametër deri në 30 cm.

3.3


TEKNIKËT E HEDHJES PËRTOKË TË PEMËVE TË PËRKULURA NË DREJTIMIN E RËNIES

Për pemët e përkulura në drejtimin e rënies ka rrezik që gjatë prerjes të thyhen papritur dhe anomalisht nga trugu për së gjati. Si pasojë trugu mund të godasë druvarin dhe mund të provokojë dëme të rënda. Për të evituar aksidentet nevojiten teknika të posaçme për këto lloje pemësh.

GDHËNDJE E THELLË (për pemë me diametër jo më të madh se gjatësia e shufrës së sharrës dhe megjithatë deri në 40 cm diametër tek niveli qafa).



1. Praktikoni prerjen e drejtimit të paktën deri në gjysmën e diametrit;
2. bëni çarje në anat e menteshës;
3. preni me shpejtësi duke filluar paralelisht nga mentesha.



Punoni gjithmonë duke filluar nga anët. Mos qëndroni kurrë mbrapa pemës, thyerja për së gjati e trugut sjell zakonisht aksidente të rënda.

Zona e rënies dhe e rrezikut në këtë rast vlerësohet si në rast normal (3.1.10.).

Për pemët me dimensione më të mëdha se 40 cm përdoret teknika "prerje me maje", për të cilën përdorimi kërkon eksperiencë dhe zotërim të mirë të përdorimit motorstegës dhe nuk ka të bëjnë me objektivet që përmban ky libër përdorimi.

3.4


TEKNIKËT E HEDHJES PËRTOKË TË PEMËVE TË PËRKULURA NË DREJTIM TË KUNDËRT TË RËNIES: PËRDORIMI I TIRFOR (ÇEKRRRIK DYSH) DHE I PRERJES SË GDHËNDJES TË GJËRË

Ky rast paraqitet kur pema duhet të hidhet përtokë në drejtim të kundërt të anës në të cilën ka pendencë.

Pemët që kanë pendencë në drejtim të kundërt nga ai që dëshirojmë, duhen të jenë të shtyra në drejtimin e duhur gjatë hedhjes përtokë, me përdorimin e detyruar të tirfor (çekrrik dysh) ose të traktorit. Pra duhet të kemi një menteshë të gjatë dhe rrezistente, për të evituar që ajo të thehet gjatë tërheqjes në drejtimin e duhur.

Zhvillimi i veprimeve

Përpara se të prisni pemën, instaloni tirfor (çekrrik dysh) ose kavon e traktorit.




1. Më përpara vëndosni zonën e menteshës, që duhet të jetë në mes të pemës;
2. vëndosni shënjën e drejtimit deri në zonën e menteshës;
3. poziciononi rrypin (është një mjet që shërben për të shtrënguar trungun) për të garantuar siguri dhe evituar thyerjen për së gjati të trungut (vetëm për pemë shumë të përkulura dhe me diametër më të madh se 40 cm);
4. shënoni menteshën dhe bëni prerjen në gjysmë të gjatësisë së gdhëndjes.

Shënime

Kur duhet të tërhiqet një pemë që ka shumë pendencë prapa, duhet të vëndosni trashësinë e saktë të menteshës duke vazhduar hap pas hapi:


- mentesha duhet të jetë e gjatë po aq sa e gjërë (1/1);
- tërhiqeni lehtë dhe pa shtyrje pemën;
- vëreni plasaritjet (nese është e prishur nga pjesa e lartë, zvogëloni pak menteshën);
- tërhiqeni lehtë dhe vëreni plasaritjet;
- kur plasaritja është e drejtuar posht, mentesha është e saktë;
- japim urdhër të ngrehim pemën me shpejtësi, për ti dhënë drejtimin e duhur.

Edhe në këtë rast duhen të respektohen rregullat e siguresës të indicuara për rast normal (3.1.10.) me nryshim që për rrezikun e hedhjes përtokë, zona e rënies dhe e rrezikut, koinçidojnë, si janë të indikuara në figurat e mëposhtme.



Montimi i tirfor (çekrrik dysh)

Në disa situata tirfor është një vegël shumë e rëndësishme, në disa është e domosdoshme si në rastin e mëpërparshëm. Mund të transportohet dhe instalohet në vënde ku nuk mund të hyjë traktori. Zvogëlon sforcimet fizike, ju lejon të fitoni kohë, të mbron pjesën tjetër të pyellit dhe mbi të gjithë të rrisni sigurinë në punë.




Hapat që duhen ndjekur:

1. ekzaminoni pemën që do prisni dhe vëndosni zonën e rënies;
2. zgjedhni krahun e instalimit (merrni parasysh terrenin dhe rreziqet);
3. vëndosni fiksimin e pemëve (il tirfor duhet të jetë më prapa kurorës së pemës që do të hedhni përtokë dhe karroca e rinisjes mjaft larg);
4. fiksoni çengelin ose kavon sa më lart që të mundeni (në qoftë se keni afër ndërtesa ose në qoftë se përdoret tërheqja dyfishe, këshillohet të përdoret një kavo me grykë);
5. kontrolloni instalimin përpara se të vendosni kavon;
6. është hedhësi përtokë që jep urdhërin e aksionimit të tirfor.

Mënyrat e përdorimit të tirfor (çekrrik dysh)


tërheqje e thjeshtë



Është montimi më i thjeshtë dhe më i përdorur.

Tek pema ushtrohet forcë e njëjtë me atë të tirfor. Tek pema ku është pozicionuar karrukulla forca është gati e dyfishtë (vendosemi poshtë dhe zgjedhim pemë fikse).

tërheqje e dyfishtë




Lejon të bëjmë tek pema një forcë dyfish më të madhe se ajo e tirfor. Përdoret kur forca e çekrrik dysh në tërheqje të thjeshtë nuk është e mjaftueshme.

Për montimin duhen dy karrukulla, një morsë dore dhe një tip spirance për lidhje.

3.5 TEKNIKËT E HEDHJES PËRTOKË PËR RASTE TË VEÇANTA

3.5.1. Teknikët e hedhjes përtokë të pemëve me diametër të vogël (më të vogla se 25 cm) me leven e hedhjes përtokë



Këto teknikë na japin mundësi të hedhim përtokë pemë me diametër të vogël dhe nuk është e muajtur të përdorim kunjët, sepse lama zë të gjithë hapësirën.

1. Ndjekni gdhëndjen e drejtimit për 1/5 të diametrit;
2. vazhdoni për 3/4 me prerjen dhe korrigjoni menteshën;
3. vëndosni mirë majen e levës (pjesa e përparme e veglës) në prerje dhe lëni një hapësirë për të bërë prerjen e fundit;
4. kompletini prerjen e hedhjes përtokë duke prerë pjerrtas, që kryqëzon prerjen e parë, në mënyrë që lama të mos prekë levën;
5. rrëshqitni pemën me ndihmën e levës së hedhjes përtokë duke bërë kujdes pozicionin e shpinës.



Kjo teknikë ka vantazhë sepse një punëtor vetëm mund ta zbalancojë pemën duke provokuar rënien.


3.5.2. Teknika e hedhjes përtokë në lartësi

Përdoret për të prerë një pemë:

- në kufi të rrugës së ngushtë për ndërhyrje gjatë tranzitit (mbrojtje ose mbështetje);
- në mal për arsye mbrojtjeje kundër rënies së borës;
- kur këmba ka karie për të siguruar siguri dhe precizion.

Kjo teknikë lejon hedhjen përtokë të pemëve pa u mbështetur trugu në këmbën e tij.

Shëmbull i një peme me karie:



1. vëndosni gdhëndjen dhe bëni një prerje me drejtim pak të thellë (gjysma e thellimit normal);
2. sharroni fletët poshtë bazës së gdhëndjes me një thellësi të rritur për një gjatësi të dyfishtë të thellësisë së gdhëndjes;
3. vëndosni dhe shënoni menteshën;
4. ndjekni prerjen e hedhjes përtokë si në rastin normal.

Kujdes: petëzat nuk duhen të sharrohen kurrë në zonën e menteshës.



Gjatë rënies:

- në fazën e parë prerja ndërprehet;
- pema përkulet në drejtimin e duhur;
- më mbrapa petëzat mbështeten njëra mbi tjetrën;
- kur të gjitha janë të mbështetura, mentesha thyhet dhe lejon trugun të bie përtokë.



PËRGADITJA E DRURIT

Përgaditja e drurit vjen pas hedhjes përtokë dhe përfshin edhe fazët e prerjes së degëve, rrotullimit të trungjeve, prerjes në pjesë të tyre dhe heqjes të lëvres së drurit. Prerja e degëve dhe ndarja në pjesë e trungut bëhen me motorrstagë dhe me vegla doret që janë kmesa dhe sakica; e para: bën prerjen e degëve dhe të pjesës më të lartë të pemës që quhet "majore"; e dyta parashikon prerjen e trungut në pozicionin, e thirur "pjesë", sipas gjatësive komerciale. Për të kompletuar prerjen e degëve mbi të gjithë perimetrin e trungut, duhet të sjellim trungun, veprim që bëhet me ndihmën e veglave.

Heqja e lëvres është heqje komplete ose e pjesshme e kores për të ndihmuar shëmbjen e drurit dhe për të parandaluar prekjen nga insektet ose kërpudhat e dëmshme për drurin përtokë dhe pemët në këmbë. Ky veprim bëhet rrallë, sepse është shumë i vështirë në qoftë se bëhet me dorë, ndërsa bëhet normalisht me sharrë.

4.1 PRERJA E DEGËVE

4.1.1. Prerja e degëve me motorrstagë



Rregulla bazë:

- mbani një pozicion të qëndrueshëm;
- qëndroni sa më shumë djathtas, mbështetni gjurin mbi trung (mbani sharrën afër trupit);
- evitoni përdredhje ose sforcime mbi shtyllën kurrizore;
- mbani gjithmonë gishtat e mëdhenj të duarve nën dorezën përkatëse;
- mbështetni sa më shpesh sharrën mbi trung;
- spostohuni kur lama është nga ana tjetër e trungut;
- mos spostoni kurrë gjurin e majtë para dorezës përparshme të sharrës;
- punoni sa të mundeni në tërheqje;
- vështroini me vëmendje tendosjen dhe ngjeshjen dhe përshtatni teknikët;
- evitoni prerjen me mbajen e lamës (rrezik që të kërcejë);
- punoni pa nxitim;
- përshtatni teknikët e punës në madhësinë e nyjeve dhe kushteve të tokës;
- përkulni gjunjët dhe jo shpinën.

4.1.2. Prerja e degëve, teknika e majes



Kjo teknikë e prerjes së degëve i përshtatet të gjithë situatave:

- degë të mëdha;
- degë në tëndosje;
- punë e rëndë.


Parimi është me pre degët, duke filluar nga maja e trungut, nga e djathta dhe nga e majta, duke filluar nga ana që është në tension. Jepni mundësi të punoni në maksimum në tërheqjes, duke ju dhënë pozicion pune ideale në qoftë se ndiqen procedurat e mëposhtme.



1. preni degët nga maja e pemës deri në fund nga ana e majtë në mënyrë që të lironi vënd për punë;




2. preni pjesën e sipërme në shtyrje, duke mbajtur motorrstegën afër trupit;



3. krasitni anën e djathtë, motorrstega e mbështetur mbi trung, pra të spostoheni në podiumin që ndjek.

4.1.3. Prerja e degëve, mënyrë skandinave




Kur nyjet kanë dimensione të vogla ose të lehta me u sharru, mënyra skandinave shton prodhimin. Kjo mënyrë mund të përdoret për trungje të vegjël ose në degët e para të thata duke i alternuar me teknikën e majes.

Zhvillimi i punës:

1. sharroni nga posh-lart në shtyrje;
2. sharroni nga e djathta në të majtë në shtyrje;
3. sharroni nga lart-posht në tërheqje;
4. sharroni nga posht-lart në shtyrje;
5. sharroni nga e majta në të djathtë në shtyrje;
6. sharroni nga lart-posht në tërheqje.

4.1.4. Prerja e degëve gjethemëdha

Për arsye sigurie, dhe për të lehtësuar punët që vijojnë, në kurorat me dimensione të mëdha duhet të veprohet si më poshtë.



Zvillimi i punës:

1. vëreni pemën dhe përreth;
2. ndiqni drejtimin normal të pregaditjes së drurit, nga këmba deri te kurora e pemës së hedhur përtokë. Sharroni degët e vogla dhe nyjet. Shënoni trungun për ta prerë në shumë pjesë deri ku fillon kurora. Në qoftë se toka ose një situatë rrezikut e kërkon, të lini trungun e plotë: kurora, duhet të ketë stabilitet maksimum. Vlerësoni me shumë vëmendje pemët e hedhura përtokë në pjerrtësi, sepse ka rrezik që të rrëshqasin duke tërhequr punëtorin;
3. në maje të kurorës spostohuni majtas dhe bëni prerjen e parë të degëve. Ndërmjet një prerje dhe tjetre lëni maksimumin 2 m distancë. Zvogëloni degët –mundësisht duke i prerë në bigëzim– në mënyrë që përtokë të rrin horizontalisht. Keni vëmendjen tek degët që janë nën tension! Mos punoni sipër gjatësisë së shpatullave;
4. pas prerjes së degëve preni në pjesë skeletin e mbetur duke filluar nga maja, duke përdorur mënyrën sipas llojit të pemës;
5. spostoni drurin për industri dhe për djegie, duke e grumbulluar në stivë të mëdha.

4.2 RROTULLIMI I TRUNGJEVE

Rrotullimi i trungjeve me madhësi të mesme dhe të vogla mund të bëhet me veglat e posaçme për rrotullimin e trungjeve. Për trungjet me dimensione të mëdha është mjaftësisht e rëndë përse i përket muskujve dhe e pamundur për drurin e lënë të gjatë, me përjashtim të përdorimit të tirfor, që justifikohet vetëm në raste të veçanta. Normalisht në rastet e fundit prerja e degëve bëhet mbi $\frac{3}{4}$ e trungut, dhe puna është e përfunduar me spostimin e drurit në vendet e mbledhjes ku ka mundësi të ngrehet me mjete mekanike.


4.2.1. Sjellja e një trungu me veglën rrotulluese të trungut




Përdorimi i veglave rrotulluese të trungut kërkon rrespektimin e rregullave të mëposhtme:

- një njeri për rrotulluesin e trungut;
- këmba e djathtë duhet të jetë e mbështetur mbrapa trupit;
- para se të tërheqni, kontrolloni zonën e punës mbrapa vetes, nuk duhet të keni pengesa (cungje, gurë etj.);
- në pjerrtësi, nuk bëhet fjalë të tërhiqet me rrotulluesin e trungut në qoftë se gjindemi në anën e trungut;
- ju vlen më shumë të rrotulloni një trung të madh me tirfor ose me traktor.

Rrotulloni trungun në tërheqje të thjeshtë



Rrotulloni trungun në tërheqje të dyfishtë



Tërheqja e dyfishtë bëhet duke rikthyer kordonin e tirfor(çekrrik dysh) me një karrukull me të cilën është e lidhur, ndërmjetëse një morsë, kordoni që rrotullon trungun. Në këtë mënyrë në kordonin e fundit ushtrohet një forcë dyfishe nga ajo që ushtrohet nga tirfor. Një sistem i tillë përdoret kur forca e tirfor(çekrrik dysh) në tërheqje të thjeshtë nuk mjafton për peshën e trungut që do të rrotullojmë.

4.3 PRERJA E TRUNGUT NË SHUMË PJESË

Prerja e trungut në shumë pjesë duhet të bëhet në mënyrë që trangu të përdoret sa më shumë dhe të merren prej tij asortimente me vlerë për merkatën. Për të bërë këtë duhet të njohim përmasat e kërkuara nga blerësi.

Zgjedhja e teknikës së ndarjes në pjesë të trungut është e diktuar nga mënyra e kërkesës së tërheqjes dhe të shtypjes së fijeve në trung.

Tërheqje = rrezik që të ndahet për së gjati;

Shtypje = rrezik që lama të mbetet e bllokuar.

Sharroni gjithmonë të parën shtypjen.



4.3.1. Prerja vertikale e thjeshtë

Në rast se pak ose hiq shtypje dhe tension.


Sipas kushteve të shtypjes dhe tërheqjes, prerja vertikale mund të bëhet nga lart-posht ose në të kundërt.



4.3.2. Prerja rrethore

Në rast shtypje dhe tërheqje të dobët:


1. të bëni një prerje sa më të thellë në zonën e shtypjes (të paktën 1/3 të diametrit);
2. sharroni anët (vetëm kur diametri i trungut është më i madh se gjatësia e lamës);
3. sharroni pjesën që mbetet duke filluar nga zona në tension.



4.3.3. Prerja rrethore e hapur

Në rast shtypje dhe tensioni të fortë:


1. të bëni një gdhëndje në zonën e shtypjes;
2. të ndiqni fazët 2 dhe 3 të prerjes rrethore në zonën e tensionit.



4.3.4. Prerja me mbyllje

Në rast shtypje dhe tensioni të fortë:

1. të bëni një prerje në zonën e shtypjes derisa prerja të fillojë të mbyllet dhe futni edhe njëherë lamën anash;
2. vazhdoni prerjen herë pas here derisa të mbyllet në zonën e shtypjes;
3. sharroni pjesën që mbetet.



4.3.5. Prerja progresive

Në rast shtypje dhe tension të fortë për trungjet me diametër të vogël:

1. të bëni një gdhëndje të vogël në zonën e shtypjes;
2. zmadhoni pak nga pak gdhëndjen deri tek thyerja e trungut të vogël.




4.3.6. Prerja si V

Në rast shtypje dhe tensioni të fortë për pemët me diametër më të mëdha se 40 cm:

1. bëni dy prerje në zonën e shtypjes duke lënë rreth 1/3 e rrethit në zonën e tensionit;
2. sharroni zonën e tensionit ngadalë për të zvogëluar pak nga pak tensionin.

Shëmbull i teknikëve të ndarjes së trungut në pjesë



Për tensione të dobëta:

- prerje rrethore.



Për tensione të mesme ose të larta:

- prerje rrethore e hapur.



Për tensione të forta:

- prerja V maksimumi deri në 40 cm diametër.



MOTORRSTEGA



Megjithëse progresi i zhvillimit të mekanizmit, motorrstega mbetet një vegël shumë e rëndësishme; vetëm duke e mirëmbajtur mund të largojmë aksidentet, mbrohet shëndeti dhe punohet me sukses. Paisja

e saj duhet të korrispondojë me nivelin teknik të sotçëm. Për të mbajtur peshën e plotë brënda mundësive të pranueshme, çdo pjesë duhet të jetë sa më e vogël dhe e lehtë që të jetë e mundur, edhe duke përballuar kërkesa të rëndësishme. Që të kemi një ide të këtyre kërkesa, mendohet që motorri bën rreth 12500 xhiro në minut dhe që zinxhiri kalon mbi lamën me 72 km/orë.

5.1 BLERJA E NJË MOTORRSTEGE

Sot në treg ekzistojnë marka të ndryshme. Si makinat, edhe modelet e ndryshme të sharrëve kanë karakteristika të ndryshme që çdo punëtorë mund ta konsiderojnë nga pikpamja e tij, vlerat ose difektet; cilësinë e një modeli, përmëtepër, mund të keqësohet ose përmirësohet brënda të njëjtit vit. Mund të ndodhin, për shëmbull, që një motorrstegë dominon tregun për një periudhë, pastaj mund të jetë pak e kërkuar dhe pas disa vitesh kthehet prap të jetë e para; është e pamuajtur që të themi, cili model është më i mirë dhe cili më i keq. Japim këtu, në çdo rast, disa këshilla që vlejné gjithmonë. Bleni motorrstegën, në qoftë se është e muajtur, te një pikë shitje afër dhe që jep një shërbim riparimi të mirë: në qoftë se prishet fitojmë kohë dhe lek.

Motorrstega duhet të jetë e dhënë me:


- libër instruksionit, lista e pjesëve të ndërrimit;
- çelës shumë përdorimi për kandelën, dadot për lamën.

Paisje të tjera shërbyese janë:

- çelsa dhe kacavita për të gjithë dadot dhe vidat e jashtme;
- grasator;
- mbrojtje lame.

5.2

PJESËT PËRBËRËSE KRYESORE TË MOTORRSTEGËS




Lista e pjesëve ndërtuese të sharrës (ndjek përshkrimin)

1. ylli(ose pulexha) i rikthimit;
2. shufra e drejtimit;
3. zinxhiri;
4. marmita;
5. doreza e kordonit të ndezjes;
6. shpejtësuesi i sigurisë me dy komandime;
7. këmbëz e përshpejtësuesit;
8. serboratori i karburantit;
9. mbulesa e ventilatorit me mekanizëm ndezje;
10. linja e shenjës;
11. serboratori i vojtit të zinxhirit;
12. doreza e prapme;
13. vida e rregullimit të karburantit;
14. cilindri;
15. doreza e përparme;
16. mrojtje për dorën e përparme me frena për zinxhirin;
17. qafa e bllokimit të zinxhirit;
18. vidë për tërheqjen e zinxhirit;
19. mbulesë e rrotës së dhëmbëzuar;
20. kundër vibrues;
21. mbrojtje e prapme për dorën.


1. dhe 2. Ylli i rikthimit dhe Shufra e drejtimit

Ylli (o pulexhia) i rikthimit ka këto vantazhe:

- zvogëlon fërkimin, pra konsumimin e zinxhirit dhe të lamës;
- zvogëlon zhurmën e zinxhirit;
- lejon një kalim më të mirë të forcave, duke shfrytëzuar më mirë potencën e motorrit;
- lejon të tërheqim më mirë zinxhirin.




Lama me yllin fiks




Lama me yllin që mund të ndërrohet

3. Zinxhiri




Organ prerës i ndërtuar nga elementa të nryshëm në formë dhe në funksion, dallohen elementa prerës, ato të drejtimit dhe ato të bashkimit. Sot janë të disponueshëm shumë lloje zinxhirësh, por me hapa standart.

4. Marmita



Silenciatori zvogëlon zhurmët dhe bashkë me kufjet për veshë, parandalojnë dëmtimin e aparatit dëgjues. Gazet dëmtuese që dalin janë idrokarbur të padjegur dhe monoksid karbonit.

6., 7. dhe 21. Përsheptësuesi i sigurisë me dy komandime dhe çelësi




Për të përmirësuar sigurinë, motorrsteget kanë një siguresë që bllokun përsheptësuesin, duke ndaluar që të aktivizohet aksidentalisht: për ta vënë në funksion, dora duhet të shtrëngojë dorezën e prapme, ndërkohësisht siguresën dhe këmbëzën e përsheptësuesit.

Përsheptësuesi rregullon xhirot e motorrit pra shpejtësinë e zinxhirit; nuk mund të hynë në aksion në qoftë se ndërkohësisht nuk reagohet mbi siguresën dhe këmbëzën.

Çelësi (21) bllokun qarkun elektrik të ndezjes, duke fikur motorrin.


22. dhe 23. Bllokuesi i përsheptësuesit dhe Starter



Në momentin e ndezjes, ky komandim jep mundësinë me blloku përsheptësuesin me gjysëm regjimi; në shumë modele ky funksionim bëhet nga starter. Kur vihet në funksionim përsheptësuesi, bllokuesi shuhet automatikisht.

Starter, që mbyll valvulen e ajrit, shërben për të ndezur motorrin kur është i ftohtë.

8. Serboratori i karburantit dhe tapa




Proporzioni i benzinës dhe vajit në përzierje për të përdorur, në përgjithësi i ndikuar jo si rraport (per es. 1:40) por si përqindje (per es. 2,5%), varet nga karakteristikat teknike të motorrsteget ose të kualitetit të vajit.

8 Tapa e serboratorit;

29 tubi i prurjes së karburantit.


5. dhe 9. Mekanizmi i ndezjes



Për të ndezur motorrin duhet të tërhiqni shkurtësisht dhe me energji dorezën e kordonit, që nga një sustë tërheqëse mbështjelllet përsëri mbi një cilindër.

- 5 Doreza;
- 9 mbulesa e ventilatorit;
- 24 kordoni i ndezjes;
- 25 cilindri;
- 26 susta tërheqëse.

15., 12. dhe 20. Doreza e përparshme, doreza e prapme, shtojcë kundër vibruese




Motorrsteget kanë dorezë kundër vibruese, pra jo të lidhur rreptësisht me bllokuesin e motorrit por të izoluara me kushineta gome ose me susta çeliku, që zvogëlojnë efektin dëmtues të vibrimeve.

- 12 Doreza në formë pistolette (ose e prapme);
- 15 doreza e përparshme (hark i vogël);
- 20 kundër vibrues.



Kundër vibrues (goma ose susta çeliku).

26. Freni i zinxhirit



Freni i zinxhirit është një mekanizëm sigurie përtë evituar aksidente nga kundra goditjet e motorrstegës. Aktivizohet në dy mënyra: automatikisht nga pesha e mbrojtjes të duarve në rast rrokullisje të fortë të motorrstegës (parim i inercisë) ose të kontaktit në mes të dorës së majtë dhe mbrojtja e dorës.

- 16 Mbrojtje e dorës me fren zinxhiri;
- 27 susta e tërheqjes (e fshehur);
- 28 fren shiriti.

18. Vidë që tërheq zinxhirin




Një ngrehje e drejtë e zinxhirit është e rëndësishme për të zvogëluar në minimum përdorimin e saj dhe atë të lamës duke garantuar kualitet dhe siguri në punë.

19. Mbulesa e rrotës së dhëmbëzuar (ingranazh)



Kjo mbulesë fikson lamën, mbulon ingranazhin dhe friksionin, mbron punëtorin nga aksidentet dhe gjatë prerjes së degëve bën punën e sipërfaqes rrëshqitëse.


30. Friksioni



Motorrsteget kanë friksion centrifugë. Kur përsheptësuesi shton numrin e xhirove të motorrit, forza shtyn peshët (prangat) përjashta dhe kundër ziles që vihet në rrotullim. Kjo e fundit povokon një lëvizje të ingranazhit, që tërheq zinxhirin.

- 17 Qafë bllokues i zinxhirit;
- 18 vidë që tërheq zinxhirin;
- 30 zilja e friksionit;
- 31 susta e friksionit;
- 32 pranga.


39. Vidë rregullimi e vajit të zinxhirit



Sasia e vajit të nevojshëm herë pas here varet nga gjatësia e lamës, nga lloji i vajit, nga lloji i drurit që keni prerë dhe nga stina. Për të rregulluar sasinë me vidë, shiko librin e përdorimit të sharrës.

- 34 Kushinetë e saçme;
- 35 pemë me manivelë (me zona lubrifikim kushinete);
- 36 pompa e vajit;
- 37 kanal vaji;
- 18 vidë mbajtëse e zinxhirit;
- 17 qafë bllokuese e zinxhirit;
- 38 vidë fiksimi dhe shul drejtimi;
- 39 vidë rregullimi të vajit.

40. Karburator



Mbi karburator janë dy vida rregullimi që kontrollojnë funksionimin e motorrit, zakonisht dallohen nga shkronja "H" (nga anglishtja high) dhe "L" (nga anglishtja low).

H = vida e maksimumit: rregullon derdhjen e karburantit me motorr plot rregjim.


L = vida e minimumit: rregullon derdhjen e karburantit me motorr në minimum.

T = vidë e rregullimit të shpejtësuesit.

40 Karburator (membrana e karburatorit);


41 flutra e starter (valvola e mbylljes së ajrit).

42. Kandela



Kandela lëshon me vrull një shkëndijë në mes të elektrodit të mesëm dhe elektrodit të masës që ndez përzierjen e karburantit. Që motorri të funksionojë mirë, është e rëndësishme që kandela të ketë gradën termike dhe gjatësinë e filetimit të parashikuara për një motorrstegë.


43. Filtri i ajrit



Filtri i ajrit, që gjendet përpara karburatorit, mban pluhra dhe papastërtira që thithen nga ajri i djegies, duke ndaluar një përdorim të tepërt të motorrit. Për të djegur një litër karburant duhen rreth. 30-40 m³ ajri.

Filtrat e ndyrë modifikojnë raportin benzin/ajër, zvogëlojnë punën e motorrit, pengojnë ndezjen, shtojnë konsumimin e karburantit dhe formimin e blozës.

Për arsye të tilla ka sisteme para-pastërtie të ajrit, në mënyrë që të zvogëlojnë shumicën e papastërtive që mban filtri. Për shëmbull në disa marka motorstege ajri që thithet tërhiqet nga një hapje afër ventilatorit të ftohjes. Rrotullimi i ventilatorit krijon një forcë centrifuge që nxjerr përjashta rërë dhe pluhra; ajri i pastruar kalon në kanal të thithjes dhe ndjek filtrin.



- 21 Çelësi;
- 22 bllokuesi i përsheptësuesit;
- 23 starter (flutra e ajrit);
- 42 kandela;
- 43 filtri i ajrit.

5.3.1. Vënia në punë

Duke përdorur motorrstegën, të sigurohemi që të mos ketë njerëz deri në 2 metra largësi.

**Ndezje me motorr të ftohtë**

1. Të zgjedhni një vënd të sigurtë;
2. të vëndosni çelësin në pozicion kontakti ("Ein - On - Start");
3. të mbyllni me starter fluturën e ajrit;
4. të bllokoni shpejtësuesin në gjysmë të punës;
5. të kapni me dorën e majtë dorezën tubore;
6. të shtrëngoni mirë në mes të kofshëve dorezën në formë pistole;
7. të rrotulloni motorrstegën nga e djathta, që të mund të tërhiqni litarin e ndezjes;
8. të tërheqni litarin me të djathtën duke i bërë një tërheqje të shkurtë por të vëndosur; për të evituar dëmtimet, mos e lini të tërhiqet prapa por shoqërojeni ngadalë;
9. në zhurmat e para të motorrit të hapni fluturën e ajrit (starter);
10. të tërheqni me forcë litarin, derisa motorri të sillet normalisht.

Ndezje me motorr të nxehtë

1. Të zgjedhni një vënd të sigurtë;
2. të spostoni çelësin në pozicion kontakti ("Ein - On - Start");
3. si për nisjen me të ftohtë, të bllokoni motorrstegën në mes të kofshëve;
4. të tërheqni litarin me të djathtën.

5.3.2. Mirëmbajtja

Sa më e komplikuar që të jetë një makinë ose një vegël, aq më shumë duhet të mbahet në gjendje të mirë. Ndodh shpesh që të shohim motorrstega të lëna pas dore, "mirëmbajtja" e të cilave konsiston vetëm në mbushjen e serboratorit; është për tu habitur se si funksionon akoma, duke menduar se ato janë në kontakt me pluhurin, pisllëqet, borën dhe lagështirën. Duke llogaritur se sa pak kohë duhet për ti mirëmbajtur, kush i lë pas dore nuk e bën për mungesë kohe por për dembelizëm dhe injorancë.

Në këtë faqe do të gjeni këshilla se si ta mbani mirë motorrstegën, në mënyrë që ajo të jetë gjithmonë e gatshme për të punuar. Përdorimi i mirë i motorrstegës ka efekt të madh në rëndimentin e punës, në difektet dhe në jetëgjatësinë e çdo makinerie; mos harroni kurrë, "sharrë e kuruar, dru gjysëm i sharruar!".

5.3.3. Vënia e zinxhirit në tension

Dëmtimet në disk dhe në lamë janë pasojë e një zinxhiri të tërhequr pak . Kontrolloni rregullisht, me motorr të fikur, tensionin e zinxhirit.

Duke luajtur zinxhirin me dorë, bëjeni të ecë në drejtim të punës (drejt majes së lamës).

Vazhdim:

1. lironi dadot e lamës;
2. rregulloni tensionin me vidën e mbajtjes së zinxhirit;
3. zinxhiri është i tërhequr mirë në qoftëse poshtë lamës nuk varet por mund të tërhiqet me dy gishta. Për të evituar vlarjen e duarve, duhet të tërhiqet gjithmonë në drejtim të punës;
4. lini zinxhirin të rrësqsë në kanal, duke kontrolluar që të përshtatet me diskun dhe lamën. Duke ngritur pjesën e pasme të lamës, shtrëngoni dadot.

5.3.4. Mirëmbajtje ditore

Mirëmbajtja e motorrstegës duhet të bëhet çdo 4 orë pune; nuk është e rëndësishme që mirëmbajtja të bëhet në mëngjes ose në darkë por që ajo të jëtë e rregullt. Mirëmbajtja duhet të mbarojë me mbushjen e serboratorit.(vaj dhe përzierje).


Materiali i nevojshëm

- Vaj për zinxhirë;
- përzierje (benzinë me lëndë lubrifikuese);
- çelës shumë përdorimësh;
- limë për hapjen e kanaleve.

Veprime për tu kryer

- Filtri i ajrit: shkundeni filtrin , dhe në se është e nevojshme lajeni me binzinë; pastroni parafiltrat;
- lama: pastroni lamën, mbulesën e rrotës së dhëmbëzuar dhe bllokimin e friksionit;
- bira e fluksit të vojtit: hiqni papastërtitë nga sipërfaqet dhe pastroni kanalizimin;
- serboratori: mbusheni plot përpara vojtit të zinxhirit, pastaj me përzierjen e benzinës me lubrifikant.

Lëndët e djegshme të përdorura për pastrimin duhen të eliminohen në mënyrë të aftë.



5.3.5. Mirëmbajtja javore

Pas 5-6 ditë pune duhet të bëhet një mirëmbajtje complete.

Material tjetër:

- penel;
- lima të sheshta;
- legena për pastrimin;
- lubrifikues.

Mirëmbajtjes ditore duhen ti shtohen disa veprime.

- **Pastrimi**

Hiqni papastërtitë me benzinë, penel dhe fije. Hiqni gjethet, mbeturinat dhe pluhurat nga krahët e ftohësit cilindrik.

- **Kujdesimi i lamës**

Limoni shkorezimin mbi sipërfaqen e rrëshqitjes së zinxhirit. Në mënyrë që këto të mos hollohen, mbajeni limën të mbështetur mirë në anën e gjërë të lamës.

- **Ylli i rinisjes**

Me lubrifikuesin vëndosni pak graso në secilën fole të pastruar.


- **Vidat**

Shtrëngoni të gjitha vidat e dukshme (veçanërisht nëse sharra është e re).


- **Kushineta e friksionit**

Lubrifikoni.

Lëndët e djegshme të përdorura për pastrimin duhen të eliminohen në mënyrë të aftë.




5.4 ZINXHIRI I MOTORRSTEGËS; PËRBËRJA DHE PËRDORIMI



Zinxhiri i motorrstegës është i përbërë nga gjashtë tipa elementesh:


1. elementi drejtues;
2. elementi prerës djathtas me kufizues thellësie;
3. elementi bashkues me përçinë;
4. elementi prerës majtas me kufizues thellësie;
5. elementi bashkues pa përçinë;
6. elementi drejtues i sigurisë.

Elementi prerës



Elementi prerës është i përbërë nga dhëmbi (me profil prerës me përbërje çelik-krom) e nga kufizuesi i thellësisë, i cili vëndos thellësinë e prerjes. Përkulja e dhëmbit mbrapa thjeshtëzimin e zdrugulinës.

1. Çatia e dhëmbit me fijen prerëse;
2. tehi i prerjes;
3. pllakë anësore;
4. baza e dhëmbit - fyti;
5. thembra;
6. fole për përçinën;
7. këmbë;
8. kufizues i thellësisë;
9. thellësia e prerjes (figura e mëposhtme).



Duke kërkuar të përmirësojmë gjithmonë prerjen, firmat ndërtuese kanë zhvilluar elemente prerës të nryeshëm.

Këto janë dy format më të përhapura të dhëmbit, rumbullake dhe si daltë.




Rumbullake (profil i rumbullakët ndërmjet pjastrës anësore dhe çatisë).




Si daltë ose anësore (profil në anë ndërmjet pjastrës dhe çatisë).

Ekzaminoni llojin e zinxhirit të çdo motorrstege dhe ndiqni instruksionet e dhëna nga ndërtuesi. Derisa elementi prerës mund të funksionojnë mirë, gjatë mirëmbajtjes rrespektoni qoshet mprehëse.


Dhëmbi rrumbullakët: qoshe sulmi anësore



Qoshja ideale është 85° nga baza horizontale, përveç disa modelesh që ndërtuesi indikon vlera të nryeshme.




Në qoftëse këndi është i gjërë, dhëmbi prenë shumë pak, duke detyruar të shtypin më shumë drurin; zinxhiri, shumë i shpejtësuar, mund të konsumohet nga njëra anë dhe thyhet.




Dhëmbi shumë i mprehtë hynë shumë në dru, duke provokuar kundra goditje ose mund të ngatërrojë zinxhirin; fija konsumohet dhe i gjithë zinxhiri dëmtohet.


Dhëmbi rrumbullakët: qoshe sulmi ballore



Qoshja ideale është 30° .
Qoshe të ndryshme nuk përmirësojnë kapacitetin e prerjes, përkundrazi shpejtojnë konsumimin e zinxhirit.




Qoshja më e vogël se 30° zvogëlon kapacitetin e prerjes.




Qoshja më e madhe se 30° elementi prerës ka tendencë jashtë dhe zgjeron prerjen, duke shpejtësuar shumë zinxhirin dhe lamën.


Dhëmbi anësor: anë e çatisë



Qoshja ideale është 60° nga baza horizontale.



Qoshe më të mëdha zvogëlojnë kapacitetin e prerjes, duke na detyruar të shtypim më shumë mbi dru ose të shkurtojmë kufizuesin e thellësisë.



Qoshe më të vogla hollojnë dhe dobësojnë fijen, që konsumohet shpejt.

Qoshja korrekte e çatisë arritet duke përdorur limën rrumbullake të diametrit të dhënë nga ndërtuesi.

Kalim në masë lineare	Marka	Diametri lima në masë lineare	Diametri lima në mm
.325	Të gjitha	3/16	4,8
3/8	STIHL	13/64	5,2
3/8	HUSQVARNA etj	13/64 o 7/32	5,2 o 5,5

Kufizuesi i thellësisë

Derisa zinxhiri të funksionojnë rregullisht dhe me një kapacitet prerje shumë të mirë, është e rëndësishme jo vetëm ti përmbahemi qosheve mprehëse por edhe të shkurtojmë kufizuesin e thellësisë.



Kufizuesi i thellësisë në lartësinë e duhur: fija hynë në dru pa presion, puna e zinxhirit në të prerë rrezulton e rregullt.




Kufizuesi i thellësisë është shumë i ulët: fija hynë shumë, motorri është i shpejtësuar, zinxhiri mund të ngatërrohet dhe të thyhet. Kundra goditje më të mëdha dhe vibracione.




Kufizuesi i thellësisë shumë i gjatë: fija hyn shumë pak, kapaciteti i prerjes së zinxhirit nuk është i shfrytëzuar plotësisht, sipërfaqja e rrëshqitjes mes zinxhirit dhe lamës konsumohen shumë.

Lartësia ideale e kufizuesit të thellësisë



Forma e dhëmbit të përkulur mbrapa, bën që, pas çdo mprehje, fija të shkurtohet pak, duke zvogëluar diznivelein (a) në krahasim me kufizuesin e thellësisë; edhe ky i fundit, pra, nganjëherë duhet të shkurtohet me limën. Zakonisht ndërtuesi jep udhëzime përsa i përket kësaj; operacioni mund të thjeshtohet me futjen në punë të veglave të posaçme.



Për të evituar kundra goditje të zinxhirit, rromullakosni edhe qoshen e pasme të kufizuesit të thellësisë.

Vlera e (a) varet nga këto tre faktor (vlerat maksimale):

Iloj sharre	Dru i fortë ose i ngrirë (mm)	Dru i butë ose i pa ngrirë (mm)
E fuqishme	0,75	1,00
E mesme	0,65	0,90
E lehtë	0,50	0,75

5.5 MIRËMBAJTJE E ZINXHIRIT

Dallohen dy operacione të nryshme:

- mprehje e thjeshtë;
- mprehje komplete.

5.5.1. Mprehje e thjeshtë

Në se zinxhiri fillon të prejë më pak, duhet të jeni në gjëndje ta mprehni në çdo moment, pa vegla të veçanta: në kushte përdorimi normale, në përgjithësi mjafton pak punë me limë. Na levërtis me e mpreh pak por shpesh: një zinxhir pa maje pren pak, rëndon punën, dëmtohet dhe dëmton motorrin. Në pyell duhet një suport që na lejon të fiksojmë lamën, të kontrollojmë qoshet e nryeshme dhe të punojmë në pozicion komod. Me pak prerje, mund të pregaditet një cung mbajtës shumë i thjeshtë dhe praktik.

Materialet e duhura:

- cung mbajtës;
- lima rrumbullake me diametër që i përshtatet tipit të zinxhirit;
- laminë e hollë për qoshet;
- çelës shumë përdorimesh ose kunj druri për të fiksuar lamën në kanalizimin e cungut.


Vazhdim



1. Kontrolloni tensionin e zinxhirit;
2. bllokoni mirë motorrstegën në këmbën e pemës;
3. vlerësoni gjëndjen e zinxhirit;
4. spostoni gjithmonë zinxhirin duke e tërhequr përpara (drejtë majes) duke përdorur doreza;
5. zgjidhni limën me diametra të duhur;
6. pozicion i punës: i stabilizuar, me këmbën e majtë ose këmbën e djathtë në linjë me limën (sipas mprehjes nga e majta o nga e djathta). Drejtoni sa më shumë me limën dorën dhe parakrahun;
7. filloni punën nga dhëmbi më i shkurtër ose nga ai më i dëmtuari;
8. shënoni dhëmbin e parë dhe mpreheni, duke rrespektuar qoshen ballore të sulmit dhe duke numëruar goditjet e limës;
9. kontrolloni qoshen e sulmit anësor nga krahi i kundërt;
10. përsëritni veprimin mbi të gjithë serinë e parë të dhëmbëve, duke i dhënë secilit të njëjtat goditje me limë;
11. vazhdoni në të njëjtën mënyrë për serinë e dytë të dhëmbëve.

5.5.2. Mprehja complete

Zakonisht mprehja complete bëhet pas shumë mprehjesh të thjeshta ose në se elementat prerës kanë pësuar dëmtime të rënda; duhet bërë mbi një cung të madh ose mbi një bankë pune, në një vend të thatë dhe me dritë ku nuk bën të ftohtë dhe nuk ka erë.



Qëllimi i mprehjes complete është të ristabilizojë:

- elementa prerës me gjatësi të njëjtë;
- qoshe mprehëse korrekte;
- kufizues të thellësisë të përshtatshëm.



Materiali i nevojshëm:


- bankë pune ose cung i madh;
- morsë për mprehje me goniometër;
- limë e rrombullakët me diametër korrispondues me zinxhirin;
- kalibri i mprehjes ose pjastres për kufizuesin e thellësisë;
- laminë për qoshe;
- dru ose kalibër për të matur gjatësinë e dhëmbëve;
- limë e sheshtë;
- çekiç.

Vazhdim

1. Sharroni një copë druri (për të hequr vojin nga zinxhiri);
2. kontrolloni tensionin e zinxhirit;
3. për të mos vlarë gishtat, duke spostuar zinxhirin tërhiqeni gjithmonë përpara (drejt majes);
4. kërkoni dhëmbin më të shkurtër ose më të dëmtuar;
5. fiksoni morsën në lartësinë e duhur mbi bankën e punës ose mbi cung;
6. shtrëngoni sharrën në morsë;
7. kontrolloni qoshet e sulmit ballor dhe anësor;
8. zgjidhni një limë me diametër të duhur;
9. pozicioni i punës: si për mprehjen e thjeshtë;
10. orientoni limën në bazë të goniometrit të morsës ose të pllakës;
11. mprehni dhëmbin e parë dhe kontrolloni nga krahi i kundërt qoshen anësore;
12. pregaditni një dru si masë gjatësie të dhëmbëve; mundësisht përdorni kalibrin;
13. mprehni të gjithë anën e zinxhirit, duke kontrolluar gjatësinë e çdo dhëmbi;
14. kontrolloni me kalibrin e mprehjes gjatësinë e kufizuesit të thellësisë dhe limojeni me limën e sheshtë;
15. hiqni motorrstegën nga morsa;
16. spostoni morsën për të mprehur krahun e kundërt të zinxhirit;
17. mprehni krahun e kundërt në mënyrë që të gjithë dhëmbët e zinxhirit të kenë të njëjtën gjatësi;
18. kontrolloni dhe limoni kufizuesin e thellësisë nga krahu i kundërt.


5.6 BLERJA E NJË ZINXHIRI

Kush blen një zinxhir të ri duhet të dinë disa të dhëna.




Lloji zinxhiri:

- forma e elementeve prerës;
- elementa sigurie.




Gjatësia:

- numri i elementave drejtues.



Hap:

- $3/8''$;
- $.325''$;
- $1/4''$.




Trashësia e elementeve motorrik:

- $3/8''$
 $0.63 = 1,60 \text{ mm}$
 $.058'' = 1,47 \text{ mm}$
- $.325$
 $.063'' = 1,60 \text{ mm}$
 $.058'' = 1,47 \text{ mm}$

Vëndosja e hapit të një zinxhiri

Hapi është distancë ndërmjet tre përçinësh e ndarë për dy.

Paraqitet në masë lineare (1 masë lineare = 25,40 mm).



Shembull:

- 19,04 mm: 2 = 9,52 mm = hap i $3/8''$
- 16,50 mm: 2 = 8,25 mm = hap i $.325''$
- 12,70 mm: 2 = 6,35 mm = hap i $1/4''$

Rregulla praktike:

- Pak më shumë se 9 mm = hap i $3/8''$
- Pak më shumë se 8 mm = hap i $.325''$
- Pak më shumë se 6 mm = hap i $1/4''$.



NJOHJE DHE MIRËMBAJTJE E VEGLAVE

Për të evituar ndalje të kushtueshme të punës, është e rëndësishme ti mbani mirë veglat. Më një mbajtje të mirë:

- zvoglohen rrisqet e aksidenteve;
- punohet më me vullnet;
- përmirësohet cilësia e punës;
- veglat jetojnë më shumë.

“Më trego veglat e tua dhe do të them kush je”.

Një proverb i modifikuar, por i vlefshëm me siguri! Kemi parë në detajë zinxhirin e motorstegës dhe mirëmbajtjen e tij; do të ishte një gabim të linim pas dore veglat e tjera. 30% e aksidenteve është e provokuar nga veglat dhe motorstega. Në depozita dhe në fazë transportimi pjesët prerëse duhen të mbulohen.

Këshilla të përgjithshme për mirëmbajtjen:

- mbani pastër veglat;
- futni pjesët prej hekri në përzierjen vaj-benzinë;
- materialet e lëkurës ose ato sintetike leni të thahen jo më shumë se në 40°C, pastaj i pastroni me brushë;
- nganjëherë, në qoftë se është e nevojshme, pastroni pjest e lëkurs me vaj të përshtatshëm;
- mbani të gjitha materialet në vende të thata.

6.1 RRIPI I PUNËS

Veshja e druvarit përmban një rrip të bërë me lëkurë ose sintetik, me mbështetje komode për:



- kunjët e hedhjes përtokë;
- çelës shumë përdorimësh për motorstegën;
- lima e rrumbullakët;
- kosa;
- shirit metrik.

Rripi i këllëfit:

- rripi;
- vendi për veglat;
- vendi i shiritit metrik;
- xhepi për kunjin;
- çengel për kosën.


6.1.1. Mirëmbajtje

- Hapeni në vend të thatë rripin e lagur. (Kujdes: përtej 40° lëkura dëmtohet);
- pastroni me një brushë;
- kontrolloni që përhapja e mbështetjeve të jetë e saktë;
- ndërroni përçinat e grisura.

Vrimëzoni rripin në goftë se është e nevojshme, por vetëm me veglën që bën vrimat.

6.2 KOSA (DRAPËR)


Kosa, pak o shumë e përhapur sipas zonave, peshon rreth 600 gr. Ka disa aplikime: e dobishme për të pastruar pedalin e trungjeve ose për të prerë degët e vogla, është si një "krah i zgjatur" i druvarit. Për motive sigurie, mprehja dhe mirëmbajtja ndryshon sipas punës së zhvilluar.



Pjesët e kosës:


1. maja;
2. lama e kthyet dhe fija (oes mpresja);
3. doreza;
4. pjesa e mbrojtjes së duarve.

6.2.1. Mirëmbajtja



Qoshja ideale ndërmjet majes dhe aksit të lamës / kapja me dorë është 90°.

Për të evituar vramje, lama nuk duhet të mprihet afër dorezës (vendi me hije).




Qoshja më e vogël se 90°: maja "ha shumë", hyn mirë në dru por nuk del me lehtësi. Me një mprehje të përshtatshme difekti mund të korrigjohet.



Qoshja më e madhe se 90°: maja "ha pak", del me lehtësi nga druri dhe provokon aksidente. Edhe ky është një difekt që korrigjohet.



Në punët e prerjes dhe të heqjes së drurit nga pylli, përdorni kosa me maje të mprehtë.



Në punët e pastrimit, meqë ka rrezik që të vriteni, përdorni kosa me maje të rrombullakët.

6.2.2. Mprehja

- Mprehni kosën duke e mbajtur pa lëvizur me gju, me morskë ose diçka tjetër;
- për të mos u prerë në qoftë se rrëshqisni, mos e mprehni afër dorezës;
- limoni gjithmonë duke u larguar nga pjesa prerëse;
- jepni pjesës prerëse një profil të mysët, që të favorizojnë shkëputjen nga druri;
- mprehni mirë pjesën e kthyer;
- hiqni koret me grihë;
- kontrolloni që mbrojtësi i duarve të jetë i fiksuar mirë.

Profili i pjesës prerëse



Lama del me lehtësi nga druri.



Lama mbetet e bllokuea, është shumë e mprehtë dhe e rrezikshme.

6.3 SAKICA

Druvarët e mëparshëm përdornin dy lloje të nryeshme sakicash për hedhjen përtokë të pemës dhe prerjen e degëve; në pylltarinë moderne, në pjesën më të madhe të mekanizuar, mjafton një sakicë universale, me peshë 1250-1800 gr.

Pjesët e sakicës

1. fija ose prerësja
2. lamë
3. syri
4. shpina
5. doreza




6.3.1. Mirëmbajtja


Sakica duhet të mprehet vetëm me limë të sheshtë ose me zmerile: disku i zmerilit do të nxehte fijen. Gjatë mprehjes vini dorezat!

Mprehje me limë të sheshtë

Mundësi fiksimit:




në gju (me gju dhe një tufë);



ndejur (në mes të kofshëve);

me ndihmën e një morse:



- mbajeni limën me dorën e djathtë ose të majtë;
- mbajeni të ndalur një dorë mbi syrin e sakicës;
- me dorën tjetër kaloni limën mbi fije; kështu shfrytëzohet mirë lima;
- që profili i prerëses të jetë i mysët, pas çdo goditje ngriheni pak limën me dorën e ndalur mbi sakicë;
- hiqni koret me grihë.

Profili i prerësit

E drejtë



I mysët

Prerja shumë e mirë.

E gabuar



I mprehtë

Lama mbetet e bllokuar në dru, fija këputet dhe konsumohet shpejt.




I rrumbullakosur

Sakica pret pak dhe kërcen, dhe ka rrezik aksidentesh.

Heqja e dorezës


Për të hequr një dorezë të vjetër, mjafton të lini sakicen 2-3 ditë me u tha në një stufë (jo në kontakt me flakën, që dëmton metalin).

Në qoftëse nuk keni kohë për ta tharë, beni si më poshtë:



1. sharroni dorezën rreth 8 cm nga syri;

2. me një fletë sharre preni drurin e mbetur anash, rreth. 1/2 cm thellësi;



3. me kmesë çani dhe tërhiqni pjesën e prerë, derisa të mbesi vetëm një cung i mesëm;

4. mbi një superfatë mbështetje, lëvizni cungun me çekiç.


Zëvendësim i dorezës

Duke i vënë dorezën e re, shikoni që të jetë nga ana e duhur.

Dy referime të mundëshme:

- maja më e mprehtë e lamës duhet të jetë e drejtuar nga doreza;
- marka duhet të jetë nga ana e djathtë e lamës.






1. Zgjidhni dorezën duke parë drejtimin e fijeve;
2. me limë të ashpër bëni dorezën si forma e syrit;
3. doreza e futur duhet të dalin nga syri rreth 1 cm;
4. doreza e futur nuk duhet të lënë boshlllek.

Në qoftëse lart dhe posht mbetet shumë boshlllek, para se të fusni kunjin e drurit sharroni dorezën diagonalisht, për ti vënë një kunj më shumë.


Kontrolloni që doreza dhe fija të jenë në linjë.

Në rast të kundërt, korrigjojeni me limë të ashpër dorezën.




Kontroll i pozicionit të dorezës:


- vini sakicën në mënyrë që dy majet të përputhen me bordin e bankës së punës;
- matni distancën A;
- distanca B duhet të jetë njëëlloj me distancën A ose pak më e madhe (1-2 cm).



Ngulja e kunjëve



1. Për të shtuar efektin e kunjit, shkurtoni majen e copës së drurit rreth 1 cm;
2. preni kunjin në gjërësinë e duhur;
3. futeni;
4. çajeni në tre pjesë me kmesë;
5. ngulni tre kunjët, duke i rrahur njëra pas tjetrës;
6. sharroni 3-5 mm nga doreza pjesët që dalin;
7. ngulni kunjët krejtësisht;
8. duke përdorur një çekiq, shtyni kunjët brënda rreth 5 mm.



Që sakica të mbajnë mirë, pas kunjimit bishti duhet të jetë "i shtypur përjashta".




Sistemimi i një bishti të liruar

- Kapni majen e bishtit dhe vëndosni lamën nga e poshtmjaja;
- rrahni mbi majën e bishtit me çakiq ose me një sakicë tjetër;
- ngulni më mirë kunjët;
- në qoftë se është e nevojshme sharroni pjesën e bishtit që del, ngulni kunjë tjera.

6.4 KUNJË ALUMINI

Për të prishur baraspeshën e pemës që do të hedhim përtokë, sot në përgjithësi përdoret një kunj aluminit ose plastik, me peshë rreth. 1200 gr.



Pjesët e kunjit:

1. rrethi aluminit ose hekrit;

2. shtojcë druri;


3. kunj kavo aluminit.

6.4.1. Zëvendësimi i shtojcës së drurit




1. Tërhiqni shtojcën e vjetër:

- kapni drurin dhe duke rrotulluar, rrahni aluminin kundër një qoshje druri;
- në qoftë se kështu shtojca nuk del, thajeni mbi një stufë (por jo mbi flakë, sepse shkrihet alumini).




2. Hiqni me sakicë ose me kmesë "mjekrrën" e ashklave që është formuar rreth unazës:


- për të mos dëmtuar as sakicën dhe as unazën, mbështetni pjesën kryesore të fijes në maje të kunjit dhe rrahni mbi një mbështetje të fortë;



- hiqni me forcë unazën, duke çarë me çekan drurin nga pjesa më e hollë.



3. Futni unazën në dru:
- që unaza të mbajë menjëherë, hapni garniturën e drurit duke e rrahur me shpinën e kmesës.



4. Futni drurin:
- druri nuk duhet të përkasë fundin e nbrëndshëm.
Në qoftë se e përket , kunji kërcen në çdo rrahje; druri mund të dalin.

6.4.2. Mirëmbajtja



- Hiqni ashklat dhe fijet e thyera;
- në qoftë se druri prekën fundin e kunjit, shkurtojeni;
- për mos tu vrarë, hiqni qoshet ose koret me limën e rrafshët.